



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1021/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gjemshir Zogaj votues paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor, për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Gjemshir Zogaj votues në Malishevë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Gjemshir Zogaj votues në të cilën pretendon se me 03 nëntor ai dhe mbi 20 familjarë të tij kanë votuar për mbesën Adelinë Berisha numrin 21 PDK ndërsa aty ka 0 vota pas rezultateve kjo nuk është e mundur dhe kërkon ta rishikojnë kutinë 3031/02 sepse personi në fjalë thotë se e ka dërguar edhe nënën e tij të paralizuar vetëm që t'i shtohen votat e lëre të mos e ketë asnjë, sipas tij është e pamundur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1021/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.